

URDHËR
Nr. 211, datë 10.6.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”; në nenet 22 e vijuese, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 9.6.2022 deri në datën 10.6.2022, me ndërprerje kur kompetencat do të rimerren nga titullari i institucionit.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka